



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË
TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT
TË INTERESAVE PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasjeje të trefishtë ndërgjegjëse, parandaluese dhe ndëshkuese;
- Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura, për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;
- Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2018 të Komisionit Europian në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektorati në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, arritjen e zbatimit të plotë të rekomandimeve të GRECO-s në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë, si dhe sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;
- Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për vitin 2018, në drejtim të:

- Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe, në veçanti, në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në Raportin e Katërt të Vlerësimit për Shqipërinë të GRECO-s, si dhe në rezolutën e Kuvendit të datës 20.9.2018 “Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”.

- Performancës në rritje lidhur me zbulimin e rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke administruar një numër total prej 3679 deklarata të interesave privatë, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë 780 subjekte deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 112 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë Prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 53 raste referimesh penale.

- Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, si një masë e domosdoshme dhe emergjente për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, duke përfunduar verifikimin e të gjitha të dhënave të paraqitura gjatë vitit në deklaratat e pasurisë për 411 subjekte të rivlerësimit dhe duke dorëzuar dokumentacionin e plotë për gjyqtarët e gjykatave të apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, si dhe prokurorët e prokurorive të apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësit dhe këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative.

- Përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, duke plotësuar 5 anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit që sipas përcaktimeve përzgjidhen mes punonjësve të institucionit, si dhe marrjen e masave për kryerjen e procesit të kontrollit për subjektet e ligjit brenda afateve të parashikuara.

- Administrimit dhe analizimit të 404 raporteve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 157 i përkasin sektorit publik dhe 247 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në dispozitat e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Zhvillimit të një sërë aktiviteteve trajnuese dhe informuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, si OSBE, Këshilli i Europës etj., me qëllim rritjen e kapaciteteve të njësive përgjegjëse të sektorit publik dhe privat për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me mekanizmat e luftës kundër korrupsionit.

- Ofrimit të asistencës teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse si struktura kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet kryesore që kanë fushë të përgjegjësisë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe parandalimin e pastrimit të parave.

- Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, si dhe forcimin e bashkëpunimit me median investigative në veçanti, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore kërkesat e publikut në lidhje me publikimin e deklaratave të interesave privatë.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, për vitin 2019, të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të vazhdojë procesin e dorëzimit të dosjeve dhe raporteve të hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përkatësisht të gjykatave dhe prokurorive të rretheve gjyqësore, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, si dhe gjykatave administrative të shkallëve të para.

- Të vijojë angazhimin, së bashku me partnerët ndërkombëtarë, për të garantuar përfundimin e të gjitha fazave të nevojshme për ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë brenda vitit 2021 dhe garantimin e qëndrueshmërisë së mëtejshme të funksionimit të vetë sistemit.

- Të vijojë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve investiguese me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të fshehjes apo mosdeklarimit të pasurive, të konfliktit të interesit, si dhe hetimit të rasteve të sinjalizimit.

- Të vijojë aktivitetet informuese e sensibilizuese në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim ndërgjegjësimin e të gjitha palëve në proces, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

- Të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës mbi ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, për zgjidhjen e problematikave të evidentuara deri më tani, si dhe të informojë Kuvendin për gjetjet e këtij vlerësimi.

- Të pasqyrojë në raportin vjetor të dhëna statistikore për kategoritë e zyrtarëve, për të cilët është kryer gjatë vitit kontrolli i plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë e të interesave privatë dhe cilat janë rezultatet e këtyre kontrolleve.

Miratuar në datën 17.6.2019